



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 06

Datë: 15. 01. 2021. Ora: 15:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Artan Asllani, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyesë: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**
- 2. Aktivitetet e SKQZ-së**

3. Aktivitetet e ZRPPC-së

4. Raport i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Personel

-Shqyrtimi i kërkesës për angazhimin e stafit shtesë për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës

-Këshilli për Çështje Ligjore

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Podujevë.

-Këshilli për Buxhet dhe Financa

-Shqyrtimi i kërkesës për buxhet shtesë për staf shtesë të angazhuar në proces zgjedhor sipas Udhezimit Administrativ Nr.01/2021

-Këshilli për Operacione Zgjedhore

- Shqyrtimi dhe miratimi i nominimeve për anëtar të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 14.02.2021

5.Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: Përshëndetje të gjithëve. Hapim mbledhjen e 6-të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. A ka ndokush vërejtje për këtë rend dite? Nga administrata me thonë që pika e këshillit për buxhet dhe financa duhet të largohet sepse, kjo do të fuzionohet me pikën nga këshilli për personel, ku do të behet ndryshimi dhe kjo pikë do të ndryshohet, pra do të jetë ndryshimi dhe plotësimi i vendimit për zgjedhjen e stafit jo permanent. Pra këshilli për buxhet dhe financa do hiqet kjo pikë, ndërsa pika e këshillit për personel mbetet me ndryshim.

Sami Hamiti: Faleminderit. Po është e vërtetë ne e kemi trajtuar para së të vije këshilli për personel të cilën e kanë trajtuar në kuadër të rregullës dhe i kanë marr edhe imputet nga këshilli për buxhet edhe financa që është gjithçka në rregull, kështu që nuk ka problem. Do të hiqet pika e këshillit për buxhet dhe financa, dhe të trajtohet për këshillin për personel.

Valdete Daka: Faleminderit. Diçka tjetër..?

Sami Kurteshi: Faleminderit Kryetare. Unë dje kam pa një reagim, ne emër të KQZ-ës lidhje më një aplikacion, ai reagim nuk është i KQZ-ës, unë kurrë nuk jam pyet as nuk jam konsultuar, nuk jam këshilluar, nuk jam njoftuar që ka një reagim të tillë nga KQZ-ja. Është fjala për një aplikacion që e paskan hapur në vendet perëndimore për ndihmë të mërgimtarëve që aplikojnë për të votuar, unë e kam hapur edhe vetë atë aplikacion dhe e kam pa për çfarë është fjala dhe pikërisht ky aplikacion është ai që është dashur që ta bej shteti i Kosovës, KQZ-ja ka pasur si investim kapital 60.000 euro, me që nuk e ka bërë, atë e kanë bërë vajza dhe djem të ri që po studiojkan jashtë, që janë rritur atje, që jetojnë në vende demokratike dhe ju përshtaten ligjeve të vendeve demokratike. Me vonë pastaj dëgjova se në të vërtetë puna ka shkuar edhe më larg, janë thirrur policia dh është bërë e madhe. Çështja është që ne vend që KQZ-ja dhe shteti i Kosovës më u gëzuar dhe me i thirr ata të ri edhe me ju than që ju e paskeni përfunduar një punë që ne nuk kemi mund ta përfundojmë edhe kemi pasur pare për këtë punë , e hajde ta shikojmë se çfarë keni bërë, ne dëshirojmë me i kriminalizu ata njerëz për shkakë që ofrojnë ndihmë mërgimtarëve me i mbush formularët. Unë po deklaroj që unë nuk e kam ditur, unë nuk jam njoftuar, nuk është reagim i KQZ-ës, personat që shkruajnë një reagim të tillë në emër të vetë, jo në emër të KQZ-ës munden më e qit emrin lirisht dhe unë nuk pajtohem aspak me reagimin dhe hapat e ndërmarur lidhur më këtë çështje, kjo është shumë e rrezikshme çka jemi duke bërë, është përpjekje e hapur për ti penguar bashkatdhetarët që të ja lehtësojmë punën për aplikim për votim në Kosovë. Faleminderit.

Valdete Daka: Faleminderit Sami. Në momentin kur dikush i paautorizuar në emrin e vet apo kujdo qoftë, apo të ndonjë OJQ-ve mbledh shënime personale të qytetarëve të Republikës së Kosovës si dhe gjirollogarit dhe kërkon donacione për regjistrimin, natyrisht që ne do të reagojmë. I vetmi institucion që edhe i autorizuar që ti ketë shënime personale jashtë është KQZ-ja. Pra askush nga askund nuk mundet ti mbledh shënime personale të askujt dhe aq më pak të qytetarëve dhe të votuesve, duke i pasur në dispozicion numrat personalë të qytetarëve, duke i pasur në dispozicion shënime personale të tyre numrat e telefonave dhe të gjitha ato dhe në jemi këtu më ditë të tera duke biseduar dhe duke tentuar që ti verifikojmë që qa janë të vërteta apo jo dhe aq më tepër duke mbledhur edhe donacione për ti përfunduar ato shërbime, pra duke paguar për ato shërbime qytetaret. Është dezinformata se KQZ-ja... se ato janë duke u bërë në emër të kujt, vetëm KQZ-ja është e autorizuar për të shpërnda dhe për të mbledhur aplikacionet dhe qe të i regjistrojë qytetaret dhe askush tjetër. Ne nuk e dimë se çfarë mund të ndodh me shënime të cilat mblidhen neperë servera të kush di kujt sepse ne nuk kemi informata dhe askush nuk mundet në emrin e vet apo në emër të ndonjë OJQ-je, dhe mbledhë shënime të qytetarëve, cili shtet në botë do e kishte lejuar që shënime personale të qytetarëve të tyre të mblidhen neperë OJQ-ë të ndryshme dhe neperë organizata që punojnë se kush e di ku. Kjo është ajo, asgjë tjetër. Nuk kisha dashur më komentuar më shumë.

Samir Kurteshi: Zonja kryetare, unë vet e kam plotësuar atë formular, sepse, nuk lypin numër personal, nën dy, nuk lypin datëlindje, nuk e lyp as emrin e prindërit, nuk kërkojnë as një donacion. Unë e kam plotësuar dhe me është kthyer edhe ka than që këtu e ke dhe e shtyp formularin dhe nënshkruan ti vetë dhe i mbush të dhënat që nuk janë këtu, e treta, ata thoin për formular i keni këtu në këtë vend i gjeni dhe të dhënat tjera i gjeni, nuk kanë kërkuar as një të dhënë sensitive, ata janë fëmijë që jetojnë në vende demokratike dhe as nuk mbledhin të dhëna, as nuk servojnë të dhëna dhe kanë një leje nga shteti që është ligjor dhe nuk është i kriminalizuar sikur Kosova. Prandaj këto qa i thatë ju z. Kryetare janë të pa vërteta sepse, unë konkretisht e kam provuar.

Në vazhdim, zhvillohet një polemikë në mes të anëtarëve të KQZ-së e cila, tejkalon kornizat zyrtare të mbledhjes.

Valdete Daka: Kush është për këtë rend dite? Me ndryshimet të cilat u propozuan. Miratohet, rendi i ditës. Vazhdojmë me rendin e ditës aktivitetet e KQZ-ës.

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Burim Ahmetaj: Faleminderit Kryetare. Të nderuar anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, raportin e kemi dërguar më herët, raporti i referohet orës 12:00, sidomos nga të dhënat nga shërbimi votues edhe po ashtu ne raport është një pjesë tjetër që shpjegon për publikimin e informatave ne ëeb-faqen e KQZ-ës, për periudhën e aplikimit, për regjistrimi të aplikusëve jashtë Kosovës. Pra janë informatat dhe pyetjet me të shpeshta të cilët i kemi përcjellur tek votuesit dhe të qytetaret që kanë ber zakonisht përmes facebook-it zyrtar që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka, po ashtu aty parashtrohen edhe pyetjet më të shpeshta lidhje me procedurat e votimit. Ndërsa pjesa e parë e raportit sqaron punën në shërbimin votues ku akoma është duke vazhduar puna për periudhën e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës e cila do të përfundoj më 21 janar në orën 18:00. Aktualisht duke ju referuar raportit të orës 12:00, ne sistem janë te futura gjithsej 3455 aplikacione për regjistrim, numri i raportuar për aplikacione për të cilët është bërë futja e të dhënave është shifër e cila mundet të pësoj ndryshime, sepse mund te kemi edhe të dhëna të cilat janë dyfishë. 3455 aplikacioneve të cilat për regjistrim, të aprovuar jenë 2249 aplikacione, statusin momental të refuzimit e kanë 431 aplikacione për regjistrim, të cilat të dërgojnë dokumentet mbështesë me qëllim të aprovimit të këtyre aplikimeve. Pra duke ju referuar këtij raportit të orës 12:00. Gjithsej janë email-e të pa hapura 16.386 email-e të cilat në proces e sipër, mirëpo shërbimi votues është duke punuar në 2 ndërrime, ndërrimin e para ditës dhe ndërrimi i pas ditës përfundon deri në mesnatë. Këto janë të dhënat nga ora 12:00 e ditës së sotme. Për informata të tjera do të ju raportojmë, në raportimin e orës 20:00, nga shërbimi votues. Faleminderit.

Valdete Daka: Vazhdojmë me aktivitete e ZRPP-ës.

3. Aktivitetet e ZRPPC-së

Yll Buleshkaj: Faleminderit Kryetare. Numrat e ZRPP-ës janë pak me të vogël, puna kryesore e zyrës është pranimi i aplikacioneve për akreditimi të vëzhguesve dhe certifikim të partive politike. Nesër në ora 06:00 është afati i fundit kur partitë politike apo subjektet politike kanë afat që të i dorëzojnë aplikacionet e plota duke përfshirë edhe listën e kandidatëve të tyre për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. Ndërsa deri me tani kemi pranuar nga këto aplikacione për aplikim, nga partia Rome e Bashkuar kemi pranuar listën

më 33 kandidatë, , nga Serbska Lista kemi pranuar listën me 20 kandidatë Do të thotë deri më tani nuk kemi pranuar ndonjë aplikacion nga komuniteti shumicë, kemi pranuar nga komuniteti jo shumicë të Kosovës. Aplikacione për certifikim të subjekteve dhe kandidatëve, zyra është duke përpunuar të dhënat një nga një ashtu siç kam than edhe më par të partitë apo subjektet që kanë pasur nevojë të dorëzojnë listën e përkrahësve, jemi aq sa po mundemi të i verifikojmë edhe përmes telefonit në mënyrë që të kemi një pasqyrë më të qartë për vërtetësinë e të dhënave të cilat janë dorëzuar. Deri me tani nuk është që kemi pasur ndonjë problem shumë të madh në vërtetim. Pra këto janë të dhënat sa i përket aplikimit për certifikim, ndërsa sa i përket të dhënave për aplikime për akreditim, përveç një rasti që kemi pasur e kemi përmendur në mbledhjen e kaluar, deri me tani kemi vetëm 6 aplikacione për akreditimi, ndërsa kemi si kandidatë 104 që kanë aplikuar për akreditim. Nuk kemi ndonjë kandidatë të pavarur, kemi vetëm iniciativa qytetare, parti politike dhe kemi 2 koalicione. Faleminderit shumë.

Valdete Daka: Faleminderit, nëse nuk kemi pyetje. Vazhdojmë më raportin e këshillave për personel.

4.Raport i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Personel

1.Shqyrtimi i kërkesës për angazhimin e stafit shtesë për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës

Gordana Llaban: Sot, më mbledhjen e këshillit për personel, në bazë të vendimit të marrë që në kuadër të kompetencave të kryeshefit që, të angazhohet kontingjenti i stafit jo permanent për procesin zgjedhorë që është para nesh. Prandaj, këshilli rekomandon që të fillohet me procedurat për angazhimin shtesë të stafit për këto zgjedhje...

Valdete Daka: E kemi rekomandimin e këshillit për personel. A ka dikush pyetje? Nëse jo. Kush është për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit? Miratohet...

Këshilli për Çështje Ligjore

2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkeses për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Podujevë.

Arianit Elshani: Faleminderit Kryetare. Këshilli për çështje ligjore ka trajtuar kërkesën për zëvendësimin e anëtarit e kuvendit komunal në komunën e Podujevës dhe me shumicë të votave ka rekomanduar që më aprovet kërkesa dhe të rekomandohet për aprovim edhe në KQZ-ë.

Valdete Daka: Atëherë, kush është që Haki Rudari të emërohet anëtar i kuvendit komunal në Podujevë nga subjekti politikë LVV-je, duke zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal Bajram Ajeti. Kush është për? Miratohet, ky zëvendësim.

Këshilli për Buxhet dhe Financa

3. Shqyrtimi i kërkesës për buxhet shtesë për staf shtesë të angazhuar në proces zgjedhor sipas Udhezimit Administrativ Nr.01/2021

Alim Rama: Këshilli për Operacione Zgjedhore, ka trajtuar emërimet e anëtareve KKZ-ës, por është një çështje që ne nuk e kemi trajtuar në këshill edhe ajo është te formulat e KKZ-ës, për ato subjekte që zgjedhjet e kaluara kane garuar me... Edhe, unë kisha lypur një sqarim partitë AAK dhe NISMA a kanë qenë në koalicione a po partie, se nëse kan qenë bashkë ne nuk kemi marr udhëzim administrativ, një udhëzim se qysh trajtohen këto përbërje të KKZ-ve, ku përbërja e KKZ-ve rregullohet me ligje përbërja e tyre. Disa parti tjera nuk janë pranuar nga KOZ-i sepse nuk kanë pasur përfaqësi.

Arianit Elshani: Është e vërtet çfarë tha z. Halimi, kemi diskutuar gjerë e gjatë dhe komunë për komunë, veç e veç kemi pa përmbajtjen e KKZ-ve, dhe kjo që e ngriti këtë çështje këtu në komision ka qenë si diskutim edhe në këshill për Operacione Zgjedhore, aty realisht kemi pa edhe rezultatet përfundimtare, kanë qenë subjektet që kanë qenë në, kemi pa edhe rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të 2019, të certifikuara dhe kështu është rregulluar edhe lista duke u bazuar në ato rezultate dhe ne ato koalicione

që kanë qenë zyrtare. Në këtë rast kjo përbërje që është sot që po propozohet është përbërje, realisht është konformligjit dhe konform procedurave të cilat na obligojnë neve si anëtar vetëm të e zbatojmë.

Valdete Daka: Atëherë, nëse nuk ka ndokush ndonjë çështje tjetër..

Artan Asllani: Faleminderit Kryetare. Unë e pash listën dhe pash në disa komuna që nëse e shohim Prishtinën, Suharekën ka përfaqësues të Partisë Demokratike të Ashkalive të Kosovës që ajo nuk është parti parlamentare dhe ne i kemi dërguar emrat e anëtareve të cilët nuk janë rekomanduar që certifikim. PDA-ja nuk është parti parlamentare në legjislaturën e kaluar, po ashtu edhe në KKZ-të, me sa e di unë duhet më qenë partitë parlamentare. Është e vërtet që ajo partitë është e komunitetit ashkali.

Në këtë pikë, diskutuan edhe: Sami Hamiti, Alim Rama, Qemajl Kurtishi.

Valdete Daka: Ashtu siç po e sqarojnë anëtarët, formula bazohet mbi bazën e votave të marruar në zgjedhjet e fundit në atë komunë për parlament. Kjo parti PLE, ka pasur me shumë vota ..

Alim Rama: Në qofte se, i kishim pranuar të gjitha rekomandimet, numri i KKZ-ve ka qenë shumë i madh të anëtareve të KKZ-ës. Një informatë janë 9 anëtar të KKZ-ës që pritet të korrigjohen emrat. Zyra i ka dërguar partive dhe subjekteve të cilat i kanë nominuar ata që i kanë mbushur të gjitha kushtet ligjore që të zëvendësohen dhe ato vinë ndërkohë.

Valdete Daka: A kemi vërejtje të tjera? Nëse jo. Kush është për aprovimin?

Sami Hamiti: Unë ende nuk e kam kuptuar, që në baze të cilit parim janë të vendosura.

Valdete Daka: Neni 67, paragrafi 1, pika A dhe B, Komisioni Komunal i Zgjedhjeve në përgjithësi ka 7 anëtar dhe ky numër mund të rritet nëse numri i subjekteve politike që kualifikohen për të qenë pjesë e komisionit është më i madh, secili komision komunal i zgjedhjeve është i përberë nga Zyrtari Ekzekutiv i KKZ-ës i punësuar nga KQZ-ja dhe i cili do të jetë kryesues i KKZ-ës, pra zyrtar i joni dhe pika B, nga një anëtar i nominuar nga subjektet politike që kanë kaluar pragun Zgjedhor në zgjedhjet nacionale nëse ju nënshtrohen pragut zgjedhor. Ndërkaq është dhe paragrafi i cili thotë që KQZ-ja duhet të përpiqet ta

garantoj përfaqësimin e drejtë në KKZ-ë, për të gjitha komunitete më numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune.

Nexhmedin Hyseni, drejtor i KKZ-ve: E nderuar z. Kryetare, të nderuar anëtar. Në bazë të nenit 67, paragrafi 1 i ligjit për zgjedhjet e përgjithshme e gjithashtu edhe në bazë të rregullës zgjedhore të 15/16, për funksionimin dhe përbërjen komunale të zgjedhjeve dhe ne mbështetje të planit operacional të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 14 shkurt të vitit 2021, sekretariati ka sjellë sot nominimet brenda afatit, ku të gjitha këto nominime, sekretariati ka pranuar nga subjektet politike prej 281 ku këto nominime ne i kemi zbatuar aktivitetet tona, për shërbimin votues që i falënderojmë edhe subjektet politike që kësaj radhe për herën e parë i kanë dorëzuar të gjitha personat e komunave përkatëse pa dallim të gjitha partitë. E po ashtu e kemi verifikuar edhe në panelin zgjedhor për ankesa dhe parashtesa se a i plotësoj kriteret të gjithë këta persona sipas nenit 5 të rregullës zgjedhore 18/2016 respektivisht paragrafin 2, pika 5 dhe të gjithë i kanë lejuar PZAP-ja që nuk e kanë të ndaluar të ushtrijnë funksionin e anëtarit të KKZ-ës.

E po ashtu, edhe në funksion të zbatimit dhe të respektimit të nenit 5 paragrafi 1, pika 4 të rregullës në fjalë. Ne i kemi dërguar emrat në këshillin gjyqësor dhe i kemi bërë verifikimin e të gjithë këtyre personave, kemi marrur rekomandimin e këshillit gjyqësor dhe do ta bëjmë zëvendësimin së bashku me subjektet politike për ata të cilët nuk e kanë plotësuar. Dhe si të tillë në Këshillin e Operacioneve zgjedhore në mënyrë anonime janë pranuar këta, këto janë dispozitat ligjore që KQZ-ja, këtë listë, në tani i kemi 281 persona që janë rekomandim i Këshillit të Operacioneve Zgjedhore për emërim në KQZ, nga 281 propozime për emërim propozohen 260 sosh. Faleminderit.

Valdete Daka: Kryesuesi i KKZ-ës, është zyrtar i jon komunal i cili, është i punësuar nga KQZ-ja, ndërsa përfaqësuarit tjerë janë anëtar të nominuar nga subjektet politike që kanë kaluar pragun zgjedhor, në zgjedhjet nacionale nëse ju nënshtrohen pragut, pra vetëm për partitë shqiptare, ndërsa komunitete përfaqësohen, pra KQZ-ja duhet të përpiqet të garantoj përfaqësimin e drejtë në KKZ për të gjitha komunitete. Pra në ato komuna ku kemi përfaqësues të komuniteteve ata duhet të përfaqësohen në KKZ, e natyrisht duke e marrur parasysh numrin më të madh të votave në zgjedhjet e fundit nacionale të atyre subjekteve në atë komunë.

Artan Asllani: Prapë, unë nuk po e përjashtojë që nuk është respektuar parimin që e keni vendosur cila parti ka pasur vota, cili komunitet ka pasur vota më shumë. Po PDAK-ja nuk e ka kaluar pragun nuk ka qenë parti parlamentare.

Sami Hamiti: Duke u munduar të jemi shumë të sakët për secilin komunitet edhe sidomos për përfaqësimin, një nga një e kemi pa çdo komunë se si janë votuar në zgjedhjet e fundit, cila ka pasur më së shumti në atë pjesë ajo është vendosur.

Valdete Daka: Artan kjo ka qenë formulë që e kemi zbatuar në të gjitha zgjedhjet jo vetëm këtë herë po edhe në të gjitha zgjedhjet nacionale këtë formulë e kemi zbatuar pra nuk është hera e parë që zbatohet gjithmonë është zbatuar kjo formulë për komunitete. Nëse nuk kemi diçka tjetër. Kush është për..? Miratohet...

Valdete Daka: Janë emrat të cilët, janë larguar për shkaqe që nuk i kanë plotësuar njërin nga kushtet dhe subjektet politike do të kenë mundësi që të zëvendësojnë në ndërkohë. Atëherë kush është për aprovimin e listës së anëtareve të KKZ-ve për zgjedhjet e parakohshme? Kush është kundër? Me 2 abstenime, dhe 8 vota për, lista aprovohet...

Të ndryshme!